



# STATISTIKA EKONOMIKE PËR TURIZMIN

*Raportim Vjetor*  
**2022**

# **PËRMBAJTJA**

**1. TË ARDHURAT PËR VITIN 2022**


**2. INVESTIMET E REJA NË FUSHËN E TURIZMIT**

**3. SHPENZIMET DITORE DHE NETËQËNDRIMET MESATARE**

**N**ë këtë buletin statistikor po sjellim të dhëna ekonomike për disa zëra në fushën e turizmit për nëntëmuajorin e vitit 2022. Të dhënat ekonomike për fushën e Turizmit mundësohen nga Banka e Shqipërisë dhe INSTAT. Turizmi tashmë është kthyer në një fushat e rëndësishme për të gjeneruar të ardhura në ekonominë e vendit.

## TË ARDHURAT PËR AKTIVITETIN UDHËTIM/TURIZËM


Bazuar në raportin e bilancit të pagesave të Bankës së Shqipërisë, të dhënat statistikore për zërin udhëtim dhe turizëm, gjatë vitit 2022, rezultojnë se të ardhurat nga vizitorët e huaj që kanë vizituar vëndin tonë për qëllimi biznesi dhe personale për aktivitetin udhëtim/turizmi janë në vlerën 2,840 mil Euro, vlerë kjo e rritur 48.5%, krahasuar me vitin 2021.



Grafik 1: Të ardhurat nga udhëtimet/turizmi për vitet 2018 – 2022 (Burimi: Banka e Shqipërisë)


Nga të dhënat e Bankës së Shqipërisë rezultojnë se shpenzimet e shqiptarëve jashtë vendit si për ata që lëvizin për arsye biznesi si ata për arsye personale për vitin 2022 llogaritet të kenë shpenzuar 1770.50 Milion Euro për zërin udhëtime/turizmi. Shpenzimet e shqiptarëve jashtë vendit për vitin 2022 janë rritur në masën 65.1%.

Më poshtë po japim një paraqitje grafike të shpenzimeve të shqiptarëve jashtë në 5 vitet e fundit.



**Grafik 2: Shpenzimet e shqiptarëve jashtë vendit për vitet 2018-2022**

Në lidhje me bilancin mes shpenzimeve të shqiptarëve jashtë me të ardhurat nga të huajt brënda vendit tonë shihet që bilanci për vitin 2022 është 1, 069 Mil Euro, kemi një rritje prej 44,6% krahasuar me vitin parardhës. Më poshtë po japim grafikun e bilancit për zërin udhëtime/turizëm për 5 vitet e fundit:



**Grafik 1: Të ardhurat nga udhëtimet/turizmi të 9 mujorit për vitet 2018 – 2022. (Burimi: Banka e Shqipërisë)**

## INVESTIMET E REJA NË FUSHËN E TURIZMIT

Duke qënë se turizmi u bë një nga fushat prioritare të zhvillimit ekonomik në vend kjo u pasqyrua dhe në rritjen e interesimit të bizneseve për të investuar në fushën e turizmit. Ky interesim i biznesit në këtë fushë duket si nga numri dhe sipërfaqja e ndërtimit, por dhe nga vlera e investuar. Më poshtë gjeni të dhëna mbi numrin e strukturave për të cilat janë dhënë leje ndërtimi gjatë vitit 2022; sipërfaqja e këtyre strukturave në total si dhe Vlera e përafërt e investuar në këto Struktura:

	2019	2020	2021	2022	RRITJA në % krahasuar me 2021
NUMRI I LEJEVE TË NDËRTIMIT PËR HOTELE E STRUKTURA TË NGJASHME	67	23	33	51	55%
SIPËRFAQJA E LEJEVE TË NDËRTIMIT MIRATUAR (M2)	418,765	76,848	144,237	198,737	38%
VLERA E PËRAFËRT E INVESTUAR (MILION LEKË)	13,784,469	2,915,634	5,183,214	7,264,278	40%


Tab 1: Burimi INSTAT

## SHPENZIMET DITORE DHE NETËQËNDRIMET

Një faktor i rëndësishëm në llogaritjen e të ardhurave që sjell turizmi në vend është dhe llogaritja e netëqëndrimeve për vizitorët e huaj, që shpenzojnë 1 natë e më shumë në Shqipëri, si dhe shpenzimet mesatare ditore që të huajtë (jo rezidentë) konsumojnë mesatarisht në Shqipëri.

Përsa i përket **shpenzimeve mesatare ditore**, për vitin 2022 për shtetasit e huaj jorezidentë, që vizitojnë Shqipërinë për qëllime biznesi, vlera e shpenzimit është 109 Euro mesatarisht në ditë, kemi një rritje prej 11 Euro në ditë më shumë krahasuar me vitin më parë. Ndërsa të huajt që kanë ardhur në Shqipëri për arsye personale kanë shpenzuar mesatarisht 61 euro në ditë, ku rezulton 9 euro më shumë se e njëjta periudhë e vitit paraardhës.

Më poshtë gjeni grafikun e të dhënave të shpenzimeve mesatare ditore për 4 vitet e fundit:



**Grafik 3: Burimi Banka e Shqipërisë**

Përsa i përket **kohëqëndrimit mesatar** për jorezidentët, shifrat tregojnë se vizitorët e huaj, që vijnë për qëllime personale në të vitit 2021 kanë një mesatare prej 5.5 netësh për arsye personale. Për jorezidentët, që kanë hyrë në Shqipëri për arsye biznesi, mesatarja ditore e netëqëndrimit është 4.8 netë krahasuar me vitin paraardhës.

Më poshtë po japim me tabelë numrin e netëqëndrimeve mesatare në 4 vitet e fundit.

KOHËQËNDRIMI MESATAR (NETË)		
	Netëqëndrimi mesatar për Bisnes	Netëqëndrimi mesatar për arsye Personale
<b>2018</b>		
<b>TI'18</b>	4	7
<b>TII'18</b>	3	6
<b>TIII'18</b>	3	5
<b>TIV'18</b>	4	5
<b>2019</b>		
<b>TI'19</b>	5	6
<b>TII'19</b>	3	5
<b>TIII'19</b>	3	5

TIV'19	3	6
<b>2020</b>		
TI'20	5	7
TII'20	4	6
TIII'20	4	4
TIV'20	4	6
<b>2021</b>		
TI'21	4	5
TII'21	4	6
TIII'21	3	6
TIV'21	4	6
<b>2022</b>		
TI'22	7	5
TII'22	3	6
TIII'22	4	5
TIV'22	5	6

*Burimi: Banka e Shqipërisë*